

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ferit Osmani, kryetar i kolegjit, gjyqtarët Hashim Çollaku dhe Gani Zabeli, anëtarë, me zyrtarin ligjor Shaban Prekalla, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarës S.A.-M., për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPK, duke vendosur sipas ankesës së të akuzuarës, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, P.nr.2601/2017, të dt.29.11.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me 02.04.2019, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

**Refuzohet** si e pa bazuar ankesa e të akuzuarës S.A.-M., kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj, P.nr.2601/2017, të dt.29.11.2018, **vërtetohet**.

### A r s y e t i m

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Themelore në Ferizaj, P.nr.2601/2017, të dt.29.11.2018, është shpallur fajtores e akuzuara S.A.-M., për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPK dhe i është shqiptuar dënimi me gjobë në shumë prej 900Euro, të cilin dënim është obliguar që të paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënim të ekzekutimit me dhunë.

Nëse dënim me gjobë nuk mund të ekzekutohet, atëherë i njëjti do të zëvendësohet me dënimin me burgim, në kuptim të nenit 47 lidhur me nenin 46 par.3 të KPK, ashtu që i njëjti do të zëvendësohet në dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 45(katër dhjetë e pesë)ditëve, duke llogaritur për çdo ditë të kaluar në burg, nga 20Euro.

Është obliguar i akuzuari që të paguaj shpenzimet e procedurës penale në shumën prej 190,88Euro, si dhe paushallin gjyqësor në shukën prej 30Euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Në kuptim të nenit 39 par.3 pika 1 të ligjit për kompensimin e viktimave të krimit, ligji nr.05/L036, është obliguar i akuzuari që në emër të kompensimit të viktimave të krimit të paguajë shumën prej 30Euro, në afat prej 15 ditëve, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

I dëmtuari F.N., për realizmin e kërkesës pasurore-juridike është udhëzuar në kontestin e rregullt civilo - juridik.

Kundër këtij aktgjykimi, në afat ligjor ka ushtruar ankesë e akuzuara, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe vendimit për dënimin, duke propozuar që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, e akuzuara të lirohet nga akuza, ose që aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe çështja penale ti kthehet gjykatës së shkallës së parë, në rigjykim dhe vendosje.

Prokuroria e Apelit në Prishtinë me shkresën PPA/II.nr.280/2019, të datës 15.03.2019, duke u sqaruar përkitazi me ankesën e të akuzuarës, ka propozuar që e njëjta të refuzohet si e pabazuar, kurse aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit në kuptim të nenit 394 të KPPK, duke vlerësuar pretendimet ankimore nga ankesa e ushtruar, propozimit me shkrim të Prokurorisë së Apelit në Prishtinë, si dhe shkresave tjera të lëndës ka gjetur se:

### **Ankesa e të akuzuarës S.A.-M., nuk është e bazuar**

Meqenëse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, nuk është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, gjykata duke vepruar në pajtim me nenin 394 të KPPK, e shqyrtoj aktgjykimin e ankimuar nëse i njëjti është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, dhe gjeti se i njëjti nuk përmban shkelje të dispozitave të procedurës penale, si dhe shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarit, të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij, për të cilat kjo gjykatë kujdeset kryesisht sipas detyrës zyrtare.

Sa i përket ankesës së të akuzuarës, e cila ankimon aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke theksuar se gjykata e shkallës së parë, nuk e ka vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike, ngase aktgjykimin e ka mbështetur kryesisht në deklaratën e të dëmtuarit, të dhënë në polici, sepse i njëjti nuk ka prezantuar në shqyrtim gjyqësor, pasi që gjendet përkohësisht në punë në Austri, e sidomos nuk e ka vlerësuar rrethanën se i dëmtuari nuk posedon patentë shofer dhe automjeti nuk ishte i regjistruar, rrethana të cilat tregojnë se i dëmtuari ëhë fajtor për shkaktimin e këtij aksidenti, andaj, si rezultat i kësaj, është dashur që në këtë çështje penale të bëhet super ekspertizë për të vërtetuar në mënyrë më të drejtë se kush është fajtor që ditën kritike është kryer vepra penale për të cilën është zhvilluar procedurë.

Kolegji i kësaj gjykate e ka vlerësuar ankesën e të akuzuarës, aktgjykimin e ankimuar si dhe shkresat tjera të lëndës dhe ka ardhur në përfundim që në këtë çështje penale gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, përkundër asaj që e akuzuara nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale të rrezikimit të trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPK. Rezulton nga provat tjera në shkresat e lëndës, e sidomos pas vlerësimit të deklaratës së të dëmtuarit i cili në mënyrë të qartë ka shpjeguar pozicionin e ndodhur të drejtueses së automjetit të udhëtarëve të markës “VË Polo”, nga pakujdesia dhe në kundërshtim me dispozitat përkatëse ligjore, është kyçur nga rruga dytësore në rrugën kryesore, e cila vërtetohet edhe në bazë të ekspertizës së ekspertit të komunikacionit, e dt.02.09.2017, i cili ka theksuar se drejtuesi i automjetit në fjalë, në mënyrë të pa sigurt është kyçur në rrugën me përparësi kalimi përkundër asaj që dukshmëria ka qenë e mirë, se nuk e ka përshtatur shpejtësinë e lëvizjes para kyçjes në rrugë, andaj, me këto veprime ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë.

Sa i përket propozimit të akuzuarës që në këtë çështje penale është dashur të bëhet super ekspertizë, kolegji i kësaj gjykate ka ardhur në përfundim se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka vlerësuar shkresat e lëndës, propozimet e ngritura nga ana e të

akuzuarës, ashtu që në këtë çështje penale nuk ka pasur të drejtë e njëjta të kërkoj super ekspertizë sepse kemi vetëm një ekspertizë të komunikacionit të punuar nga inxhinier XH.M., kurse ekspertizë tjetër nuk ka pasur për të plotësuar kushte për punimin e super ekspertizës, andaj, ekspertizës së punuar si dhe shkresave tjera të lëndës, gjykata në mënyrë të pa dyshimtë ka vepruar sipas dispozitave përkatëse ligjore për zhvillim të procedurës dhe pasi që ka vërtetuar se në veprimet e të akuzuarës konsistojnë elementet qenësore të veprës penale të rrezikimit të trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPK, është shkaktuar aksidenti i komunikacionit, me çrast i dëmtuari F.N., ka pësuar edhe lëndime trupore, të cilat janë konstatuar në bazë të ekspertizës mjeko ligjore të dt.07.10.2017, të përshkruara si lëndime të lehta trupore, kolegji vie në përfundim se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë dhe të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike, ashtu që aktgjykimi i ankimuar e ka mbështetjen e duhur ligjore.

Për shkak të vendimit për dënimin, duke theksuar se gjykata e shkallës së parë, të akuzuarës i ka shqiptuar dënim të rëndë, ngase nuk ka vlerësuar rrethanat se e njëjta asnjëherë më parë nuk ka ra në kundërshtim me ligjin dhe nuk është gjykuar, ashtu që vendimi është tejet i ashpër.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, ankesën e ushtruar, si dhe shkresat e tjera të lëndës, dhe ka ardhur në përfundim, se nga ana e gjykatës së shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë është vërtetuar gjendja faktike, se aktgjykimi i ankimuar nuk përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, si dhe shkeljet e ligjit penal, se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë me rastin e marrjes se vendimit për dënimin, caktimit të llojit dhe lartësisë së tij, në kuptim të nenit 73 të KPK, sikurse janë rrethanat lehtësuese, se e akuzuara asnjëherë tjetër nuk ka ra në kundërshtim me ligjin, se është e martuar, nënë e një fëmiu, se është e punësuar në arsim si mësimdhënëse, kurse ka vlerësuar edhe rrethanat rënduese, sikurse janë: shkalla dhe intensiteti i kryerjes së veprës penale, andaj, në prani të këtyre rrethanave, në ankesën e të akuzuarës nuk ka gjetur ndonjë rrethanë posaçërisht lehtësuese, ashtu që kolegji i kësaj gjykate, është i bindur se me dënimin e shqiptuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij i paraparë me nenin 41 të KPK, që të parandaloj kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëj rehabilitimin e tij, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëj kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale, dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Nga sa u tha më lartë e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPPK, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**PA1. nr.261/19 të datës 02.04.2019**

**Zyrtari ligjor**  
**Shaban Prekalla**

**Anëtarët e kolegjit**  
**Hashim Çollaku**

**Kryetari i kolegjit**  
**Ferit Osmani**

**Gani Zabeli**